

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI JURIDIK
DREJTIMI KUSHTETUES - ADMINISTRATIV



**Roli i Kuvendit të Kosovës në procesin e përafrimit të legjislacionit
nacional me EU-Acquis
(Punim Masteri)**

Mentori:

Prof. Dr. Arsim Bajrami

Kandidati :

Lekë Kelmendi

Prishtinë, Shtator, 2024

ABSTRAKT

Ky studim shqyrton rolin e Kuvendit të Kosovës në procesin e përafrimit të legjislacionit kombëtar me EU-Acquis, duke vlerësuar rëndësinë e këtij procesi për integrimin evropian të vendit. Pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008, Kosova ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt afërsisë me standardet e Bashkimit Evropian, të cilat përfshijnë reforma të thella në fushat politike, ekonomike dhe sociale. Kuvendi, si institucioni kryesor legjislativ, ka një rol kyç në hartimin dhe miratimin e ligjeve që përmbushin kriteret e BE-së.

Procesi i integritimit është thelbësor për stabilitetin politik dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës. Përafrimi i legjislacionit ndihmon në krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm dhe të parashikueshëm për investitorët, si dhe në forcimin e shtetit ligjor dhe qeverisjes së mirë. Standardet e EU-Acquis ofrojnë një kornizë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe promovimin e demokracisë, duke përmirësuar kështu cilësinë e jetës për qytetarët e Kosovës.

Megjithatë, procesi i integritimit përballlet me sfida të rëndësishme. Mungesa e resurseve adekuate dhe bashkëpunimi ndërinstytucional shpesh pengojnë efektivitetin e Kuvendit në monitorimin dhe zbatimin e ligjeve të përafruara. Kjo situatë kërkon angazhim të vazhdueshëm dhe përpjekje të koordinuara për të adresuar këto pengesa. Në përfundim, ky studim ofron një vlerësim të rëndësishëm mbi përparësitë dhe sfidat që ndihmojnë në përcaktimin e strategjive të ardhshme për Kuvendin e Kosovës në rrugën drejt integritimit evropian.

Fjalë kyçe: Kuvendi i Kosovës, EU-Acquis, integrimi evropian, legjislacioni.

